



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2, nenit 87, paragrafi 6 dhe nenit 127, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), nenit 20 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 08.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 10/2024

FLETËVOTIMET DHE BROSHURAT

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton përmbajtjen, formatin dhe dukjen, mënyrën dhe kontrollin e shtypjes, verifikimin, shpërndarjen dhe transportin, veçoritë e sigurisë dhe çështjet tjera të lidhura me fletëvotimet dhe broshurat.

Neni 2

Llojet e Fletëvotimit

1. Për qëllim të zgjedhjeve përdoren këto lloje të fletëvotimeve:
 - 1.1. Fletëvotimi për Kuvendin e Republikës së Kosovës – shtojca I;
 - 1.2. fletëvotimi për kuvendin komunal – shtojca III;
 - 1.3. fletëvotimi për kryetar komune – shtojca V

Neni 3

Përmbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit

1. Fletëvotimi përmban:

- 1.1. Stemën e Republikës së Kosovës dhe logon e KQZ;
- 1.2. përshkrimin e llojit të zgjedhjeve dhe kornizën me ngjyrën përkatëse;
- 1.3. emrin e komunës për zgjedhjet lokale;
- 1.4. tekstin udhëzues që tregon mënyrën e votimit për subjektin politik dhe kandidatët;
- 1.5. hapësirën katrore për shënjim të subjektit politik;
- 1.6. numrin e subjektit politik të përcaktuar sipas shortit, radhitja bëhet duke filluar nga numri më i vogël;
- 1.7. logon e subjektit politik;
- 1.8. emrin dhe akronimin e secilit subjekt politik, sipas vendimit për certifikim;
- 1.9. hapësirën e kufizuar për shënjim që përmban numrat e kandidatëve të subjektit politik;
- 1.10. tiparet e sigurisë të përcaktuara me vendim të KQZ.

Neni 4

Përmbajtja dhe përshkrimi i broshurës

1. Broshura përmban listat me emrat e kandidatëve, shtojca II – mostra e broshurës për zgjedhjet për kuvendin e Kosovës dhe shtojca IV- mostra e broshurës për zgjedhjet për kuvend të komunave, të cilët garojnë për zgjedhje dhe përmban:
 - 1.1. Stemën e Republikës së Kosovës dhe logon e KQZ;
 - 1.2. llojin e zgjedhjeve;
 - 1.3. emrin e komunës për zgjedhjet lokale;
 - 1.4. përshkrimin grafik dhe tekstual për mënyrën e votimit;
 - 1.5. listën e përmbajtjes së broshurës;
 - 1.6. numrin e subjektit politik të përcaktuar sipas shortit, duke filluar nga numri më i vogël;
 - 1.7. logon e subjektit politik;
 - 1.8. emrin dhe akronimin e secilit subjekt politik, sipas vendimit për certifikim;
 - 1.9. numrin e kandidatit të renditur, duke filluar nga numri më i vogël;
 - 1.10. emrin dhe mbiemrin e kandidatëve të subjekteve politike.

Neni 5

Detajet teknike të fletëvotimeve dhe broshurave

1. Fletëvotimet dhe broshurat shtypen në letër të bardhë në peshë 80g/m². Ngjyra e letrës dhe shtypit është identike në të gjitha fletëvotimet.
2. Fletëvotimet në pjesën e sipërme apo anash, duhet të jenë të vrimëzuar nga pjesa amë. Vrimëzimi është 1cm nga skaji i fletëvotimit, që lejon shkëputjen e lehtë të fletëvotimit gjatë dhënies së fletëvotimit votuesit.
3. Fletëvotimet përmbajnë së paku tri veçori të sigurisë, që i bëjnë të mbrojtura nga kopjimi apo falsifikimi. Veçoritë e sigurisë janë:
 - 3.1. **Mikroshtypi** – ku shtypen karaktere apo një mostër e caktuar në një madhësi të vogël, e padukshme për sy, ku duhet të përdoret një zmadhues për t'u parë;
 - 3.2. **UV Print** – një dizajn unik vendoset në pjesën e përparme të fletëvotimit, që mund të shihet vetëm përmes UV–llambës;
 - 3.3. **Anticopy** – mbrojtje nga kopjimi – si element i cili mbron fletëvotimin nga kopjimi. Ky element vendoset në pjesën e përparme të fletëvotimit dhe në momentin që një fletëvotim kopjohet, shfaqet shenja dalluese se ai është i kopjuar;
 - 3.4. Fletëvotimet kanë një shenjë të veçantë dalluese që propozohet nga operatori, i cili bën shtypjen e fletëvotimeve dhe është unik për nga mënyra e krijimit dhe identifikimit të tij.
4. KQZ pajiset nga prodhuesi me sqarimet dhe elementet e nevojshme për vërtetimin e origjinalitetit të fletëvotimeve, që mund të përdoren me miratimin e KQZ.
5. Fletëvotimet kanë numrin serik, që shtypet në anën e sipërme të djathtë të pjesës amë, e cila mbetet pas shkëputjes së fletëvotimeve. Numri serik është tetë shifrorë dhe fillon nga 01000000.
6. Në fletëvotim shtypet kodi i Vendvotimit (VV), që është kombinim i shkronjave dhe numrave, e që ndërlidhë fletëvotimin me VV. Ky kod shënohet në pjesën e përparme dhe të pasme të fletëvotimit.
7. Në fletëvotimet rezervë shtypet shkronja “R”.
8. Për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ngjyra e kornizës së fletëvotimit është e kuqe, ndërsa ngjyra e tekstit në brendësi është e zezë.

9. Për zgjedhjet lokale, ngjyra e kornizës së fletëvotimit për kryetar të komunës është e verdhë, ndërsa ngjyra e tekstit në brendësi të fletëvotimit është e zezë.
10. Për zgjedhjet lokale, ngjyra e kornizës së fletëvotimit për kuvende komunale është e kaltër, ndërsa ngjyra e tekstit në brendësi të fletëvotimit është e zezë.
11. Për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, formati i fletëvotimit është A3.
12. Format i fletëvotimeve për kryetar të komunës në raundin e parë, është A4.
13. Format i fletëvotimeve për kryetar të komunës në raundin e dytë, është A5 – Shtojca VI.
14. Format i fletëvotimit për kuvend komunal është A3.
15. Format i broshurës është A4.
16. Kopërtina e broshurës është A4 120 g/m² dhe e ngjitur në mes.
17. Ngjyra e kopërtinës tek broshura është identike me atë të fletëvotimit, për zgjedhjet përkatëse.
18. Fletëvotimet dhe broshurat nuk përmbajnë shënime apo logo të kompanisë që bën shtypjen, apo brendit të letrës që përdoret për shtypje.
19. KQZ mund të vendosë ndryshe për përcaktimin e formatit final të fletëvotimit, bazuar në numrin e subjekteve politike të certifikuara.

Neni 6

Përgatitja dhe miratimi i fletëvotimeve dhe broshurave

1. Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ) përgatitë dizajnin e fletëvotimeve dhe broshurave, sipas specifikave teknike të fletëvotimeve dhe broshurave.
2. Menjëherë pas certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje, Departamenti i Teknologjisë Informative Zgjedhore (DTIZ) bën dizajnin e fletëvotimeve dhe broshurave, bazuar në informacionet e pranuar nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra).
3. DTIZ, sigurohet që paraqitja e të dhënave të subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotim dhe në broshurë, hapësira për secilin subjekt politik, madhësia dhe tipi i shkronjave të tekstit dhe numrave, si dhe madhësia e logos, të jenë të barabarta.
4. Fletëvotimet dhe broshurat shtypen në të dy gjuhët zyrtare, ndërsa në komunat ku është gjuha e tretë në përdorim zyrtar, vendoset si gjuhë në fletëvotim dhe broshurë.

5. Zyra bënë kontrollin përfundimtar të përmbajtjes të fletëvotimeve dhe broshurave, verifikimin e numrave të subjekteve politike, logot, akronimin, emrat e subjekteve politike, të kandidatëve dhe numrave të kandidatëve.
6. Pas kontrollimit të saktësisë së të dhënave, fletëvotimi dhe broshura miratohen nga KQZ dhe procedohen për shtypje.

Neni 7

Numri i fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen

1. Pas certifikimit të listës votuese, KQZ përcakton numrin e fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen për secilin VV dhe fletëvotimet rezervë, nëse parashihen.
2. Numri i fletëvotimeve të shtypura nuk mund të tejkalojë më shumë se pesë përqind (5%) e numrit të votuesve në listën votuese.
3. Me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve dhe ruajtjes së integritetit të zgjedhjeve, bazuar në trendet e pjesëmarrjes në zgjedhjet paraprake, KQZ vendosë për shtypjen e më pak fletëvotimeve sesa numri i votuesve. Në këtë rast, duhet të ketë një numër të fletëvotimeve rezervë.
4. KQZ shqyrton propozimin dhe miraton numrin e fletëvotimeve dhe broshurave të cilat shtypen.

Neni 8

Procesi i shtypjes dhe paketimit

1. Specifikimet teknike përmbajnë të gjitha informatat e detajuara për shtypjen, paketimin dhe transportimin e fletëvotimeve dhe broshurave.
2. Shtypja e fletëvotimeve dhe broshurave bëhet tek operatori ekonomik (OE) i kontraktuar në pajtim me legjislacionin për prokurimin publik në Kosovë, sipas kriterëve të kësaj Rregulloreje.
3. Procesi i shtypjes dhe paketimit bëhet nga OE i certifikuar, në pajtim me standardet për sistemin e menaxhimit të shtypjes me siguri të lartë dhe sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit.
4. Pas shtypjes së ekzemplarëve të parë (pre print), menaxheri i caktuar nga Drejtori i SKQZ e përcjellë tek Këshilli për Operacione Zgjedhore për shqyrtim formën e shtypur.
5. KQZ miraton formatin përfundimtar për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave.

6. Fletëvotimet dhe broshurat paktohen në kuti të madhësisë së njëjtë, të cilat lidhen dhe etiketohen.
7. Etiketimi i secilit paketim gjeneron të dhënat përmes skanimit dhe përmban këto informacione:
 - 7.1. Komunën;
 - 7.2. kodin e vendvotimit;
 - 7.3. numrin e fletëvotimeve në kuti.
8. Fletëvotimet rezervë paktohen në pako të ndara.
9. Fletëvotimet dhe broshurat për ekipet për votuesit me nevoja të veçanta (votuesit në institucione), merren nga pakot e fletëvotimeve dhe broshurave rezervë.

Neni 9

Mbikëqyrja dhe kontrolli gjatë shtypjes dhe paketimit

KQZ bën mbikëqyrjen dhe kontrollin gjatë shtypjes dhe paketimit të fletëvotimeve dhe broshurave.

Neni 10

Ruajtja dhe transportimi

1. Ruajtja dhe transportimi i fletëvotimeve dhe broshurave, bëhet në pajtim me standardet dhe legjislacionin në fuqi për ruajtjen dhe transportimin e letrave me vlerë të interesit të lartë shtetëror.
2. Pas përfundimit të shtypjes dhe paketimit, fletëvotimet dhe broshurat dërgohen në depon qendrore të KQZ.
3. Fletëvotimet dhe broshurat dërgohen nga depo qendrore në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), në mënyrën dhe afatin e caktuar nga KQZ.
4. SKQZ dhe Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) kujdesen që hapësirat për ruajtje dhe mjetet e transportit përmbushin standardet dhe legjislacionin në fuqi, për të parandaluar dëmtimin apo humbjen gjatë ruajtjes dhe transportit të materialit zgjedhor.

Neni 11

Fletëvotimet dhe broshurat rezervë

1. Fletëvotimet rezervë, vendosen në depon e QKN dhe mund të shfrytëzohen vetëm kur ka kërkesa nga Këshilli i Vendvotimit (KVV).
2. Në rastet kur kryesuesi i KVV, bazuar në trendin e daljes së votuesve dhe numrit të fletëvotimeve që kanë në dispozicion, vlerëson se ekziston nevoja për fletëvotime shtesë, kërkon pajisjen me fletëvotime nga Kryesuesi i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ).
3. KKZ, menjëherë pas pranimi të kërkesës, vendos për dërgimin e fletëvotimeve në VV që ka kërkuar fletëvotime shtesë. Në të njëjtën kohë, kryesuesi i KKZ e informon KQZ për kërkesën dhe detajet e transportimit.
4. Së paku dy anëtarë të KKZ marrin fletëvotimet rezervë dhe i transportojnë tek QV, përkatësisht VV, sipas procedurave për transportimin e materialit të ndjeshëm, të miratuar nga KQZ.
5. Dorëzimi bëhet në hapësirat e VV që ka kërkuar fletëvotimet, në prezencën e anëtarëve të KVV dhe vëzhguesve, nëse janë prezent. Kryesuesi i VV dhe njëri nga anëtarët e KKZ nënshkruajnë formën e pranim–dorëzimit.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja Nr.10/2023 Fletëvotimet dhe Broshurat, e datës 09.03.2023.
2. KQZ, harton procedurë të veçantë për transportimin e materialit të ndjeshëm zgjedhor brenda dhe jashtë vendit.
3. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat si në vijim:
 - 3.1. Shtojca I – Mostra e fletëvotimit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;
 - 3.2. shtojca II – Mostra e broshurës për zgjedhjet për kuvendin e Kosovës;
 - 3.3. shtojca III – Mostra e fletëvotimit për zgjedhjet për kuvend të komunave;
 - 3.4. shtojca IV – Mostra e broshurës për zgjedhjet për kuvend të komunave;
 - 3.5. shtojca V – Mostra e fletëvotimit për kryetar të komunës;
 - 3.6. shtojca VI – Mostra e fletëvotimit për kryetar të komunës – raundi i dytë.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi